

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje paisje te pergjithshme mobilimi dhe zyre per institucionet e Konviktit,Kopshtit dhe Çerdhes-Bashkia Puke

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

39290000-1 Mobilime te ndryshme

VLERA E FONDIT LIMIT:

3,678,000 (Tremilion e gjashtëqinde e shtatedhete e tetemije) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Puke ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022,2023 dhe 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të**

ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilanci e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/ datë 05.03.2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilanci, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrijnë ose e kalojnë shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrijnë ose e kalojnë shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar**

Kerkohet për 2 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qenë sa më konkurruese për të gjithë op.ekonomik të vegjël apo të mëdhenj.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë “Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet 2022,2023,2024 ku vlera e xhiros për **të paktën një nga vitet** e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet”. Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë: Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpërmendura.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke parë vlerën e fondit limit të përcaktuar e cila nuk është e lartë dhe vlera 40% e fondit limit për xhiro vjetore nuk cenon pjesëmarrjen e op.ekonomik as atyre që janë biznes i vogël duke garantuar konkurrencë të hapur dhe mos cenimin e asnjë op.ekonomik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entitet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Kerkohet për 3 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qenë sa më konkurruese për të gjithë op.ekonomik të vegjël apo të mëdhenj. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben AK për të vërtetuar se op.ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratë

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron **aktivitet për vitin** e fundit (këstet e maturuara) (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore **për vitin** e fundit (këstet e maturuara) .

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632,datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvorjen e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke parë vlerën e fondit limit për këtë objekt mendojmë që marzhi i përcaktuar 20 % i cili është dhe maksimali për këtë model procedure vendoset për të demonstruar që op.ekonomik kanë furnizime të ngjashme të kësaj natyre dhe jap garanci për realizimin e kontratës sipas specifikimeve dhe afatit të realizimit. Vlera e ngjashme nuk cenon asnjë op.ekonomik pasi është e perballueshme dhe në proporcion të plotë me objektin

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së ciles deklaron se plotëson të gjitha specifikimet teknike dhe merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallrave, dhe montimit të tyre Brenda kushteve teknike në vendin zyrtar të parashikuar nga AK Brenda afatit të përcaktuar.

Argumentimi Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteri është vendosur për të garantuar që produktet që ofrohen të jenë nga subjekt i licensuar sipas legjislacionit shqiptar dhe që garanton furnizimin sipas sasive të përcaktuara dhe specifikimeve teknike .

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën 1 vjeçare të garancisë së mallrave që kërkohen të prokurohen nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar.

Deklaratat shërbejnë si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi do të jetë në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen të operatorit ekonomik kontraktues, si dhe garantohet kryerja e shërbimeve për riparimin e mjeteve, gjatë periudhës së garancisë.

2.4.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente konkretisht:

- a) Çertifikate **ISO 9001 - 2015** “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”, ose ekuivalente si **(SSH/UNI/EN/ISO)** objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit
- b) Çertifikate **ISO 14001-2015** “Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- c) Çertifikate **ISO 45001-2018** “Për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në Punë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto çertifikata të jenë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontratës së bashkepunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, pika 1 dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Çertifikatat e kërkuar janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

- Çertifikate ISO 9001:2015 ose ekuivalente si **(SSH/UNI/EN/ISO)** Sistemet e menaxhimit të cilësive është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombetare që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësive për ato strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet të adoptojnë për një orientim të mirë në standartet e tregut. Ak gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me këto license me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në azhvimin e veprimtarisë së tij e cila do të sjellë dhe avogelimin e kosteve, pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesi të ofrojë cilësi më të mirë me çmime më të ulëta.
- Çertifikate ISO 14001:2015 Sistemet e menaxhimit të ambientit ofron një kuader praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. Ak gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me këto license me qëllim që veprimtaria që ushtrohet nga ai (në rastin konkret realizimin i punës së objektit të prokurimit) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të sajë dhe të përmasojë performancën mjedisore. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

- **Certifikate ISO 45001-2018** (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurise ne Pune) eshte standart nderkombetar,i cili parashtron kerkesat per menaxhimin e praktikave te mira te sigurise dhe shendetit ne pune per çdo organizate ,subjekt pavarsisht nga madhesia.Ak e gjykon se çdo ofertues duhet te jete i pasur me kete lçense me qellim qe veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (ne rastin konkret realizimin i punes se objektit te prokurimit)te realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurise dhe shendetit ne pune.Kjo kerkese sherben si garanci extra qe do te sjelle reduktimin e aksidenteve te mundshme ne pune dhe semundjeve ne vendin e punes duke minimizuar kostot si dhe kohen ne permbushje me sukses te kontrates se punes objekt i prokurimit.

2.4.4 Op.ekonomik duhet te sjelle vertetim qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka op,ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi.

Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi:Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77,pika 3 e LPP si dhe nennit 43,pika 6 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. ,LIGJIN NR.9632 ,DATW 30.10.2006”Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar,ligjin nr.9920 date 19.05.2008”Per procedurat Tatimore”i ndryshuar,neni 3.1/a ,b,c dhe neni 40,ne ligjin 131/2015 ”per QKB”i ndryshuar.

2.4.5 Op.ekonomik duhet te permbush dhe kushtin per sjelljen e dokumentacioni te percaktuar ne DST per **Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:**

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialist i i shërbimeve pjesë e njësive të prokurimit në përputhje me nevojat dhe përshatjen me vendin ku do vendosen. .

Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit:

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në përlogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Preventivuesi, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë shërbim, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për mënyrën e përlogaritjes të vlerës së prokurimit bazuar në nenin 76 të VKM 285 date 19.05.2021.

Sa i përket respektimit të pikës “a”, grupi i Punës ka kontrolluar në faqen zyrtare Institutit të Statistikave (INSTAT), për të marrë informacion mbi çmimet për objekt” duke specifikuar të dhënat e nevojshme për identifikimin e këtyre artikujve që Autoriteti Kontraktor “DPPGJ” kërkon. INSTAT nuk disponon çmime të botuara për këtë lloj procedure.

- ***Sa i përket respektimit të pikës “c”, grupi i Punës nuk mund të marrë si shembull çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara pasi nuk është realizuar ndonjëherë një shërbim apo blerje e tillë.***

Preventivuesi, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje malli, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për logaritjen e vlerës limit të kontratës (fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Lidhur me këtë proces, grupi i punës ka argumentuar dhe dokumentuar referuar materialeve bashkelidhur, konkretisht:

- ❖ *Sa i përket respektimit të pikës “b”, Preventivuesi, bazuar në rregullat e tregut, ka kryer studimin e tregut nëpërmjet marrjës së ofertave, për të njohur për aq sa është e mundur, nivelin e tregut aktual. Operatorët Ekonomik të përzgjedhur në mënyrë rastësore për marrjen e ofertave për testimin e tregut, janë subjekte tregtare të liçensuara dhe të regjistruar pranë QKB dhe referuar objektit të veprimtarisë së tyre të publikuara në faqet on-line respektive, por edhe sipas Ekstraktit të Regjistrimit publikuar në faqen zyrtare on-line të QKB, rezultojnë se kanë në objektin e veprimtarisë së tyre, fushen objekt prokurimi.*

Preventivuesi ka kontaktuar me këto subjekte që operojnë në treg, për marrjen e ofertave. Format e komunikimit me subjektet e tregut kanë qenë ato të parashikuara në ligj dhe në varësi të rrethanave dhe mundësive reale të komunikimit. Subjektet që veprojnë në këtë sektore, janë njohur me sasitë dhe specifikimet teknike të kërkesave tona, për sa i përket, dhe identifikimit të artikujve në treg, në mënyrë që këta të fundit të kishin mundësi të analizonin dhe të jepnin ofertat e tyre të përafërta, Preventivuesi ka marrë në treg 3 (tre) oferta ekonomike.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në specifikimet teknike që janë hedhur në dokumentet teknike të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Njesia Prokurimit